



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2025:001121
Datë: 04.03.2025
Numri i dokumentit: 06937892

AA.nr.151/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti, kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në konfliktin administrativ të paditëses-propozueses, Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit i Ndërmarrjes Shoqërore “Përparimi” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës- Agjencia Kadastrale e Kosovës me seli në Prishtinë, dhe Komuna e Shtimes, për shkak të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses-propozueses, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.18/2025, të datës;29.01.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.03.2025, merr këtë,

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses-propozueses, Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit i Ndërmarrjes Shoqërore “Përparimi” me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.18/2025, i datës 29.01.2025, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.18/2025, të datës 29.02.2025, është vendosur, “*HUDHET si i palejueshëm propozimi i propozuesit, Agjencia Kosovare e Privatizimit / Autoriteti i Likuidimit i Ndërmarrjes Shoqërore “Përparimi”, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia e paditësit dhe të anulohet aktvendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës nr.03/882/24 i datës 18.11.2024 dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës të regjistrojë pronën në emër të NSH “Përparimi” në Prishtinë.*”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë paditësja, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave procedurale, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Gjykatës

Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.18/2025, të datës 29.02.2025, dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se, ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi në konflikt administrativ me datë 06.01.2025, kundër të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të tij, nga arsyet e dhëna në padi.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit paraprak të propozimit të paditëses ka vlerësuar se propozimi është jo e plotë dhe jo i rregullt. Prandaj, me aktvendimin, e datës;08.01.2025, i ka ftuar paditësin që ta rregullojë propozimin, ashtu që i ka detyruar që ta rregulloj anën formale të padisë-propozimit ashtu që të përcaktoj se cilin vendim kërkoj që të shtyhet dhe gjykatës t'ia dorëzoj padinë përmirësuar në kopje të mjaftueshme, në të kundërtën gjykata do të merr aktvendim me të cilin do ta hedhë poshtë padinë si të palejueshëm.

Paditësi vendimin për plotësimin e padisë-propozimit e ka pranuar me datë 09.01.2025, mirëpo i njëjti nuk ka bërë plotësimin e tij brenda afatit të përcaktuar nga gjykata, e as më pas.

Pas kësaj Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, jashtë seance, bie aktvendimin e ankimuar, me të cilin është hedhur propozimi e paditëses me arsyetim se *“Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë/propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ka gjetur se paditësi/propozuesi, nuk e përcakton saktë vendimin përfundimtar në procedurë administrative të cilin kërkon ta shtyj, mirëpo kërkon që të anulohet vendimi i të paditurës Agjencisë Kadastrale të Kosovës nr.03/882/24 i datës 18.11.2024 dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës të regjistrojë pronën në emër të NSH “Përparimi” në Prishtinë. Gjykata me Aktvendimin e datës 08.01.2025 i ka kthyer paditësit/propozuesit në precizim dhe plotësim propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ashtu që në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit të rregullojë anën formale të padisë/propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Paditësi/propozuesi aktvendimin për rregullimin e padisë/propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, e ka pranuar me dt.09.01.2025, mirëpo edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar prej 8 ditësh, e as më pas, nuk i ka evituar të metat e padisë/propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Nga kjo Gjykata, vlerëson se paditësi/propozuesi nuk i ka eliminuar të metat e padisë/propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, sipas aktvendimit të datës 08.01.2025 sipas udhëzimit të gjykatës, andaj Gjykata nuk mund të vazhdoj me shqyrtimin e mëtutjeshëm të propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, për arsye se propozimi për gjykatën është i paqartë dhe nuk mund të kuptohet saktë se ekzekutimi i cilit akt administrativ kërkon të shtyhet. Andaj, gjykata nuk mund të vazhdojë me shqyrtimin e mëtutjeshëm të propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.”*

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata

e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Kolegji i apelit vlerëson si të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, pasi që paditësit nuk kanë bërë rregullimin e padisë sipas sugjerimeve të dhëna në aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë. Andaj, aktvendimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është marrë duke respektuar dispozitat ligjore, konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe me zbatim të drejtë të së drejtës procedurale, sepse paditësi, nuk e ka bërë rregullimin e padisë sipas udhëzimeve të Gjykatës së shkallës së parë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të shtyhet vendimi i të paditurës pa e përcaktuar se cili vendim kërkon që të shtyjë dhe arsyet pse kërkon që i njëjti vendim të shtyhet me prova konkrete.

Kolegji i apelit verën se nuk është bërë rregullimi propozimit të kërkuar sipas aktvendimit për plotësim të padisë-propozimit, dhe nuk janë evituar të metat e padisë, në drejtëm rregullimit të anën formale të padisë-propozimit ashtu që të përcaktoj se cilin vendim kërkoj që të shtyhet dhe gjykatës t'ia dorëzoj padinë e përmirësuar në kopje të mjaftueshme.

Në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka hedhë poshtë propozimin e paditëses si të palejueshëm, kjo për faktin se paditësja nuk e ka bërë plotësimin e propozimit sipas kërkesës së gjykatës, ngase kanë ekzistuar pengesa procedurale për vendosjen lidhur me propozimin si të tillë.

Prandaj sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe procedura është zbatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ashtu që ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
AA.nr.151/2025, datë 03.03.2025

Kryetar i kolegjit,
Hajriz Hoti